



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:213016
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637054

KPPP.nr.1623/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qëndrim E.Gashi B.I - NPT “Eurosteel”, me adresë në fshatin Gërllicë, Komuna e Ferizajit, me NUI: 811083245, kundër debitorit S.H.D. B.I - NTSH “Arditi-D”, me adresë në Prizren, magjistrerja Prizren-Gjakovë, me NUI: 810994625, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.33/2023 të datës 03.03.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit S.H.D. B.I.,-NTSH “Arditi-D”, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.33/2023 të datës 03.03.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.33/2023 të datës 03.03.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.199/22 të datës 27.06.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 859.99 Euro, me kamatë ligjore 8 % deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, debitori ka ushtruar prapësim me arsyetimin se kreditori e ngarkon gabimisht me shumën prej 859.99 Euro, pasi që debitori e ka paguar borxhin në shumën e lartcekur, dhe si provë është fatura e vulosur nga banka Raiffeissen, me nr.200/22. Më tej ka theksuar se kreditori i ka thënë debitorit që pagesën ta bëj për faturën 200/22, siç edhe është në pagesën-dëshminë e Raiffeissen Bank, ndërsa e ka dërguar më herët faturën me nr.199/22, por vet kreditori i ka thënë debitorit që pagesën ta bëj për faturën 200/22, ku edhe është bërë pagesa në shumë prej 3000 Euro, duke shtuar se më nuk ka pasur obligim ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit ndërsa të refuzohet kërkesa e kreditorit si e pabazuar, si dhe të lihet jashtë fuqie urdhri i Përmbaresit Privat, i datës 03.03.2023.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se sa i përket deklaramit të debitorit se kinse sipas udhëzimeve të kreditorit pagesa e shumës prej 3,000.00 Euro është bërë për faturën 200/22 është i pavërtetë dhe i pabazuar, për faktin se fatura nr.199/22 e datës 27.06.2022 nuk është paguar asnjëherë. Lidhur me faturën që debitori ia ka bashkangjitur prapësimin me nr.199/22 në vlerë prej 3,000.00 Euro e në të cilën është shënuar si e “falsifikuar”, kreditori ka theksuar se kjo është një mashtrim nga ana e debitorit, për faktin se fillimisht në faturën nr.199/22 në vlerë prej 3,000.00 Euro, gabimisht ishte evidentuar numri i faturës, por i cili është korrigjuar menjëherë, dhe fatura e korrigjuar është nënshkruar nga vet debitori, dhe po e njejta faturë edhe është paguar. Ka shtuar se asnjëri nga pretendimet e debitorit nuk kanë bazë në dispozitën e nenit 71 të LPP-së, dhe se pretendimet e tilla nuk mund të paraqiten në procedurë përmbarimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, dhe të lihet në fuqi urdhri mbi lejimin e përmbarimit i Përmbaresit Privat. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas TA në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.199/22 të datës 27.06.2022 në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.199/22 e datës 27.06.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës edhe pse kreditori rezultoi fitues i këtij procesi, megjithatë ai nuk e ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës autorizimin e përfaqësuesit, prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme t’ia njoh shpenzimet procedurale.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1623/23, me datë 18.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.